



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2022:115292

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05458386

**CAP.nr.68/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtari individual Adnan Konushveci, në çështjen përmbartimore të kreditorit Finca Kosovë, me seli në Prishtinë, Rruga “Robert Doll”, nr.112, të cilën e përfaqëson Ardian Kastrati, drejtor i përgjithshëm, ndaj debitorëve F.R, F.R dhe L.R, që të tre nga Gj, Rruga F.L nr..., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Armend Deskaj, avokat nga Prishtina, me bazë juridike kthim i kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve, të ushtruar kundër aktvendimit CPK.nr.112/22 të datës 16.11.2022 të Gjykatës Themelore në Gjilan, me datë 15.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të debitorëve F.R, F.R dhe L.R, që të tre nga Gj, Rruga F.L nr..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.112/22 të datës 16.11.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin e atakuar CPK.nr.112/22 të datës 16.11.2022, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e ushtruar nga debitorët Fitim Rexhepi, Fetije Rexhepi dhe Luljeta Rexhepi, kundër urdhrit për përmbartim P.nr.195/2022 i datës 26.04.2022, i lëshuar nga përmbartuesi privat Sefer.Sh.Sherifi nga Gjilan, dhe ka mbetur në fuqi urdhri për përmbartim P.nr.195/2022 i datës 26.04.2022.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i debitorit debitorët, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi në tersi si të bazuar ankesën e debitorëve dhe ta anuloi në tersi aktvendimi e atakuar, si dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhri përmbartimor P.nr.195/22 i

dt.26.04.2022 sa i përket borxhit kryesor, kamatës ligjore dhe shpenzimeve të procedurës përmbaremore ose ta prish aktvendim e shkallës së parë dhe çështjen juridike përmbaremore ta kthen në rigjykim të serishëm.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pathemeltë**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbareim ndaj debitorëve në bazë të dokumentit përmbareues-marrëveshjen mbi Huan me nr.148660, si dhe ankesë kontratës mbi riprogramin e kredisë nr.172623, dt.25.08.2020, marrëveshja mbi pengun, si dhe konfirmimin mbi regjistrimin e pengut R-20200826-286, të regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë-Zyra për Regjistrimin e Pengut. Përmbareuesi privat e ka lejuar përmbareimin e kërkuar me urdhrin P.nr.195/22 i dt.26.04.2022, ndaj të cili urdhër debitorët kanë paraqitur prapësim me datën 11.05.2022, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 19.05.2022. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Përmbareuesi privat ka lejuar përmbareimin duke u bazuar marrëveshjen mbi Huan me nr.148660, si dhe ankesë kontratës mbi riprogramin e kredisë nr.172623, dt.25.08.2020, marrëveshja mbi pengun, si dhe konfirmimin mbi regjistrimin e pengut R-20200826-286, të regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë-Zyra për Regjistrimin e Pengut. Nga kjo rezulton se përmbareuesi privat si dhe gjykata e shkallës së parë drejtë kanë vepruar kur kanë lejuar përmbareimin gjegjësisht kanë refuzuar prapësimin, ngase sipas ligjit përmbareimi lejohet në bazë

të dokumentit përbarimor dhe dokumentit të besueshëm. Në rastin konkret kemi të bëjmë me marrëveshjen mbi pengun të regjistruar në regjistrin zyrtar sipas ligjit siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 22, paragrafi 1.7.a të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, se dokument përbarues është: “kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut”, e që në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përbarimit.

Duke marr parasysh pretendimet ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përbarimore dhe as të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Andaj, në bazë të asaj që u tha më lartë aktvendim i gjykatës së shkallës së parë u deshtë që të vërtetohet dhe të refuzohet ankesa e debitorëve si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**CAP.nr.68/2023 me datë 15.03.2024**

**Gjyqtari**  
Adnan Konushevci